



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 202/6 prot.

Tiranë, më 9.5.2023

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 632, datë 8.3.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Laurent Fuçia
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 25.4.2023, është njoftuar vendimi nr. 632, datë 8.3.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit, z. Laurent Fuçia, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Vlorë.

Ndaj këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”, të aneksit të Kushtetutës, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 25.4.2023, është depozituar akti “Rekomandim për paraqitje ankimi”, nënshkruar nga një komision prej tre përfaqësuesish të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Florian Balhysa, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, datë 25.4.2023, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 632, datë 8.3.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Laurent Fuçia, ushtron detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Vlorë dhe, në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1¹ e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Laurent Fuçia, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e tri kriterëve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si raportin për vlerësimin e pasurisë nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim referuar si KLGJ), nga të cilat rezulton se:

2.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Laurent Fuçia”², ka referuar se:

- i Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv Nuk ka kryer deklaram të rremë;
- v Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Laurent Fuçia, nr. *** prot., datë **.11.2017, ka referuar “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Laurent *** Fuçia”. Ky raport është hartuar në pritje të përgjigjes nga SHISH.

2.3 KLGJ, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit raportin³ për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Laurent Fuçia.

3. Përfundimet e Komisionit, për secilin kriter, kontrolli në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** [...] Në përfundim, bazuar në konkluzionet më lart për të gjitha pasuritë e deklaruara në procesin e rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. ...Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit arrin të justifikojë bindshëm pasuritë e tij, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3, të aneksit të Kushtetutës, duke arritur në

¹ Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, Dh dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

² Shkresa e ILDKPKI-së me nr. ***/** prot., datë **.3.2018.

³ Raport i KLGJ-së nr. ***/** prot., datë **.12.2019.

përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm lidhur me kriterin e pasurisë në kuptim të nenit D të aneksit të Kushtetutës, në kreun IV të ligjit nr. 84/2016⁴ [...].

3.2 Për kontrollin e figurës. [...] Trupi gjykues, në kushtet që nga hetimi i kryer: (a) nuk konstatoi mangësi në lidhje me plotësimin e deklaratës së kontrollit të figurës apo vërtetësisë së të dhënave nga subjekti i rivlerësimit; (b) nuk u evidentuan rrethana që mund të përbënin indicie për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit apo të mund të cenonin figurën e subjektit sipas dispozitave ligjore të kreut V të ligjit nr. 84/2016; (c) nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të aneksit të Kushtetutës – çmon se subjekti i rivlerësimit Laurent Fuçia ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të gurmës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016⁵[...].

3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale. [...] Gjithashtu, trupi gjykues, lidhur me marrjen e vendimit nr. ***, datë **.10.2013, vlerëson se çështja e përmendur më lart nuk është e mjaftueshme për ta kualifikuar subjektin e rivlerësimit si “me mangësi” apo “i papërshtatshëm” në drejtim të vlerësimit të kriterit të aftësisë profesionale, në kuptim të nenit 44, gerrat “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve ose viktimave, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme. Gjithashtu, kjo çështje nuk përbën shkak që mund ta çonte trupin gjykues në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të dhënës dhe drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit, në vlerësimin tërësor të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Laurent Fuçia është “i aftë”, pasi ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe është eficient në masë të pranueshme [...].⁶

4. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet Ç, D, DH dhe E të aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, gurmën “a” të pikës 1, të nenit 58, dhe në pikën 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka vendosur [...] 1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Laurent Fuçia, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Vlorë. 2. Në zbatim të pikës 4, nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, të përcjellë aktet e çështjes civile nr. ***/2013 dhe vendimin nr. *** akti, datë **.10.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Vlorë, pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore [...].

⁴ Referohuni f. 32 të vendimit të Komisionit.

⁵ Referohuni f. 32-33 të vendimit të Komisionit.

⁶ Referohuni f. 71-72 të vendimit të Komisionit.

II. Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)

5. Bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”⁷ e aneksit të Kushtetutës dhe nenin 65, pika 2⁸ e ligjit nr. 84/2016, një komision i përbërë nga tre përfaqësues të ONM-së, më datë 25.4.2023, kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë aktin me nr. prot. 220/1: “*Rekomandim për paraqitje ankimi*” ndaj vendimit nr. 632, datë 8.3.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Laurent Fuçia (bashkëlidhur dhe pjesë e këtij ankimi).

5.1 Në mënyrë të përmbledhur, ONM vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës, lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale. Në lidhje me këtë kriter, ONM, në Rekomandimit e datës 25.4.2023, ka çmuar se një vlerësim i drejtë i provave të administruara dhe aplikimi i drejtë i kuadrit ligjor të zbatueshëm, i jep mundësinë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, të ndryshojë vendimin e Komisionit, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

5.2 Në këto rrethana, ONM kërkon që i gjithë kriteri i vlerësimit të aftësive profesionale t’i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, për çështjet që kategorizohen si: (1) *raste që paraqesin një gjykim të dobët me gabime thelbësore dhe serioze*, si dhe (2) *raste që paraqesin një seri të qartë dhe të vazhdueshme të gjyqimeve të gabuara*.

III. Vlerësimi i Komisionerit Publik

6. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting). Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim referuar si Kolegji).

7. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

8. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

9. Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i vendimit nr. 632, datë 8.3.2023, në zbatim dhe të Rekomandimit të ONM-së, datë 25.4.2023, çmon se ai është i cënueshëm në tërësinë e tij dhe

⁷ Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra ... u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit.

⁸ Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë të paraqesë rekomandim me shkrim Komisionerit Publik për të paraqitur ankim. Ky rekomandim jepet nga një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të ONM-së.

përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Për sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 632, datë 8.3.2023, të Komisionit.

IV. Analiza e shkaqeve të ankimit

IV. A Lidhur me gjetjen në vlerësimin e aftësive profesionale

10. Bazuar në përcaktimet e nenit E të aneksit të Kushtetutës, vlerësimi i kriterit të aftësive profesionale për subjektet që ushtrojnë funksionin e gjyqtarit, bazohet në aftësinë për të marrë vendime gjyqësore, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin, për të identifikuar konfliktin e normave, për të përdorur parimet e përgjithshme të së drejtës dhe aftësinë për të analizuar jurisprudencën. Ndërsa për burimet dhe procedurën mbi të cilat kryhet ky vlerësim, neni 42, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, orienton në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për aq sa ky ligj gjen zbatim.

11. Ndërkohë, lidhur me efektin që kanë gjetjet në procesin e rivlerësimit të subjektit, Komisioneri Publik mban në vëmendje jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, vendimin nr. 2/2017, ku, ndër të tjera, arsyetohet se: [...] *Në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht 'të pasakta' nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shihni edhe opinionin CDL-AD (2016)036, të Komisionit të Venecias) [...].*

12. Sa më sipër, Komisioneri Publik, në zbatim dhe të Rekomandimit të ONM-së, datë 25.4.2023, kërkon nga Kolegji i Posaçëm i Apelit të rivlerësojë në tërësi kriterin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Fuçia, mbështetur edhe në konstatimet e organeve ndihmëse të procesit për elemente të tjera të rivlerësimit, duke i nënshtruar shqyrtimit gjyqësor gjetjet dhe mangësitë e rezultuara gjatë hetimit administrativ⁹, të kategorizuara si: (1) *raste që paraqesin një gjykim të dobët me gabime thelbësore dhe serioze*, si dhe (2) *raste që paraqesin një seri të qartë dhe të vazhdueshme të gjykimeve të gabuara*.

13. (1) Raste që paraqesin një gjykim të dobët me gabime thelbësore dhe serioze

14. Prokurori i Përgjithshëm, në datën **.7.2014, ka depozituar në KLD ankesën ndaj dy vendimeve gjyqësore penale të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për mosrespektim formal të ligjit dhe për revokimin dhe shuarjen e masës së sigurimit “arrest me burg”, të dhënë nga gjyqtari Laurent Fuçia.

15. (1) Vendimi nr. *, datë **.8.2012, për “Revokim i masës së sigurimit ‘arrest në burg’, vendosur ndaj shtetasit ***,** me vendimin nr. ***, datë **.5.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke urdhëruar për lirimin e menjëhershëm të tij...”**

⁹ Komisioni, ndër të tjera, gjatë hetimit administrativ administroi nga KLGJ raportin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, ankesat e paraqitura në Këshillin e Lartë të Drejtësisë ndaj tij për periudhën 1.1.2006 deri në gusht të vitit 2020, si dhe ankesat e përcjella nga KLGJ pranë ILD-së, për z. Laurent Fuçia.

15.1 *Rrethanat e faktit.* Shtetasi ***.*** është shpallur person në kërkim ndërkombëtar nga autoritetet italiane të drejtësisë, në bazë të urdhër-arrestit ndërkombëtar të datës **.7.2011, të lëshuar nga Gjykata e Leçes (Itali), për veprat penale të “Pjesëmarrjes në organizatë kriminale” dhe “Trafikimit të lëndëve narkotike”. Nga shërbimet e policisë gjyqësore, pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë, në datën **.4.2012, ora 23.00, është realizuar arrestimi për qëllime ekstradimi i shtetasit ***.***.

15.1.1 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Vlorë, ka paraqitur përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Vlorë kërkesën për miratimin e arrestit ndërkombëtar dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” ndaj shtetasit ***.***.

15.1.2 Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Vlorë, me vendimin nr. ***, datë **.5.2012, ka vendosur miratimin e arrestit ndërkombëtar dhe caktimin e masës “arrest në burg” me afat 40 ditë ndaj shtetasit ***.***. Pas paraqitjes së kërkesës për ekstradim nga ana e shtetit kërkues dhe të kërkesës për caktim mase sigurimi nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Vlorë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Vlorë, me vendimin nr. ***, datë **.6.2012, ka vendosur caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” ndaj shtetasit ***.***.

15.1.3 Në lidhje me ekstradimin e shtetasit ***.*** drejt Italisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Vlorë, me vendimin nr. ***, datë **.6.2012, ka vendosur mospranimin e kërkesës për ekstradim¹⁰.

15.1.4 Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. **, datë **.7.2012, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë **.6.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Vlorë, duke gjykuar çështjen në fakt dhe duke vendosur miratimin e ekstradimit të shtetasit ***.*** nga Republika e Shqipërisë drejt Republikës së Italisë.

15.1.5 Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë ka ushtruar rekurs shtetasi ***.***, i cili ka kërkuar gjithashtu dhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit penal të Gjykatës së Apelit Vlorë. Kryetarja e Gjykatës së Lartë, me anë të urdhrit nr. **, datë **.7.2012, ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit penal nr. **, datë **.7.2012, të Gjykatës së Apelit Vlorë, që i përket kërkuesit ***.***.

15.1.6 Me vendimin nr. ***, datë **.11.2012, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga i arrestuari ***.*** kundër vendimit nr. **, datë **.7.2012, të Gjykatës së Lartë.

15.1.7 Pas dhënies së urdhrit për pezullim ekzekutimi të vendimit nr. **, datë **.7.2012, të Gjykatës së Apelit Vlorë, nga Kryetarja e Gjykatës së Lartë, kërkuesi ***.*** me kërkesën e datës **.8.2012, ka kërkuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Vlorë revokimin e masës së sigurimit “arrest me burg”, të caktuar sipas vendimit nr. ***, datë **.5.2012, me arsyetimin se pasi kanë kaluar 3 muaj nga fillimi i ekzekutimit të saj dhe akoma nuk ka përfunduar procedimi përpara gjykatës.

¹⁰ Në referencë të nenit 491/1/c i K. Pr. Penale: “nuk mund të jepet ekstradimi... c) kur personi që kërkohet ka kryer një veprë penale në Shqipëri”. Ndaj shtetasit ***.*** ka filluar procedimi penal për veprën penale “Armëmbajtje pa leje”, parashikuar nga neni 274/2 i K. Pr. Penale.

15.1.8 Subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë **.8.2012, ka vendosur revokimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” për qëllime ekstradimi ndaj shtetasit ***.***, duke urdhëruar lirim të menjëhershëm të tij.

15.1.9 Subjekti, ndër të tjera, ka arsyetuar se: [...] *terminologjia e përdorur nga ligjvënësi “nuk ka përfunduar procedimi përpara gjykatës”, i referohet jo vetëm procedimit përpara Gjykatës së Shkallës së Parë, por edhe procedimit përpara Gjykatës së Apelit, derisa vendimi të marrë formë të prerë, sepse nga ky moment, deri në plotësimin e afatit 30-ditor, i lind e drejta Ministrit të Drejtësisë, të disponojë në lidhje me ekstradimin (neni 499 i K. Pr. Penale) [...]. Më pas, vijon arsyetimin: [...]...kur vendimi i Gjykatës së Apelit është pezulluar me urdhër të Kryetares së Gjykatës së Lartë, atëherë ai nuk mund të ekzekutohet... çka do të thotë se, në funksion të parashikimit të nenit 493/4, të K. Pr. Penale, procedimi përpara gjykatës nuk ka përfunduar ende në kushtet kur procedimi përpara gjykatës nga data **.4.2012 deri në paraqitjen e kërkesës **.8.2012, kanë kaluar më shumë se tre muaj [...].*

15.1.10 Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë **.10.2012, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë **.8.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Vlorë, duke rrezuar kërkesën e shtetasit ***.*** për revokimin e masës së sigurimit “Arrest në burg për qëllime ekstradimi” (vendim i cili është ekzekutuar nga shërbimet e policisë gjyqësore në datë **.2.2014).

15.1.11 Gjykata e Apelit Vlorë, në vendimin nr. ***, datë **.10.2012, ndër të tjera, ka arsyetuar se: [...] *duke iu referuar vendimit gjyqësor që ka vendosur masën shtrënguese ndaj kërkuarit për efekt të gjykimit të kërkesës për ekstradim¹¹ dhe çastit kur ka përfunduar procedimi para Gjykatës së Apelit për shqyrtimin e kësaj kërkesë¹², nuk rezulton të ketë kaluar ky afat i përcaktuar në këtë dispozitë. Për rrjedhojë nuk konstatohet shkak i përcaktuar në ligj, që cenon në revokimin e masës shtrënguese. Vendimi nr. **, datë **.7.2012, i Gjykatës së Apelit Vlorë është vendim përfundimtar dhe i formës së prerë, duke qenë menjëherë i ekzekutueshëm. Rekursi, sipas dispozitave të K. Pr. Penale, nenit 432, është mjet i jashtëzakonshëm ankimi dhe në kuptim të fazave të procesit gjyqësor, procedimi quhet i përfunduar me përfundimin e shqyrtimit të kërkesës nga Gjykata e Apelit. Gjykata e Apelit çmon se pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. **, datë **.7.2012, të Gjykatës së Apelit Vlorë nuk ka indikacion mbi masën vendosur për të garantuar këtë proces ekstradimi, pasi ky pezullim lidhet me të tjera shkaqe dhe konkretisht me ekzistencën e një tjetër procedimi penal në RSH, deri në përfundimin e tij. Në këtë rast, nuk ka më referim tek afatet e veçanta që parashikon neni 493, i K. Pr. Penale, por referimi do të bëhet te dispozitatat mbi afatet e masave të sigurimit [...].*

15.1.12 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. ***, datë **.11.2012, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit ***.***, kundër vendimit nr. ***, datë **.8.2012.

15.1.13 Komisioni në rezultatet e hetimit ka konstatuar se: [...] *subjekti i rivlerësimit në vendimin e tij, fillimisht arsyeton se termi i përdorur në nenin 493/4: “nuk ka përfunduar procedimi përpara gjykatës”, i referohet jo vetëm procedimit përpara Gjykatës së Shkallës së Parë, por edhe procedimit përpara Gjykatës së Apelit. Më pas arsyeton se në kushtet kur*

¹¹ Vendimi nr. ***, datë **.5.2012, Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë.

¹² Vendimi nr. ***, datë **.7.2012, Gjykata e Apelit Vlorë.

*vendimi i Gjykatës së Apelit është pezulluar me urdhër të Kryetares së Gjykatës së Lartë dhe nuk mund të ekzekutohet në funksion të parashikimit të nenit 493/4, të K. Pr. Penale, procedimi përpara gjykatës nuk ka përfunduar. Duket se ky arsyetim i fundit i subjektit është kontradiktor me arsyetimin e parë, ku pranon se procedimi quhet i përfunduar kur ka mbaruar shqyrtimi në dy shkallët e gjykimit. Neni 493/4, i K. Pr. Penale, i referohet faktit që procedimi penal duhet të ketë përfunduar brenda 3 muajve nga marrja e masës së sigurimit në të dy shkallët dhe nuk i referohet Gjykatës së Lartë. Në rastin konkret, procedimi ka përfunduar brenda afatit 3-mujor dhe, për pasojë, masa e sigurimit nuk mund të revokohet. Në përfundim ... duket se subjekti ka marrë vendimin nr. ***, datë **.8.2012, në interpretim të gabuar të nenit 493, pika 4, të Kodit të Procedurës Penale [...].*

15.1.14 Komisioneri Publik, në zbatim edhe të Rekomandimit të ONM-së, datë 25.4.2023, ashtu sikurse do të trajtohet dhe në paragrafët vijues, konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe në një vendim tjetër gjyqësor, për të njëjtën çështje¹³, ka interpretuar sërish gabim nenin 493/4 të K. Pr. Penale, pasi vendimi nr. **, datë **.7.2012, i Gjykatës së Apelit Vlorë, që ka vendosur miratimin e ekstradimit, duhej të konsiderohej i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, dhe afati 3-mujor nuk kishte kaluar në atë kohë. Për më tepër, afati 3-mujor nuk ka të bëjë me momentin/kohën e lëshimit të vendimit mbi kërkesën e ekstradimit, por me finalizimin e procedurave autonome, mbi zbatimin e masave paraprake.

15.2 (2) *Vendimi nr. ***, datë **.7.2014, për “Revokimin e masës së sigurimit personal ‘arrest në burg’, caktuar ndaj shtetasit ***.***, me vendimin nr. ***, datë **.5.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Vlorë, lënë në fuqi me vendimin nr.***, datë **.10.2012, të Gjykatës së Apelit Vlorë (i ekzekutuar...më **.2.2014), duke urdhëruar për lirimin e menjëhershëm të tij...”.*

15.2.1 *Rrethanat e faktit.* Shtetasi ***.***, në datën **.7.2014¹⁴, ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Vlorë kërkesën për shuarjen e masës së sigurimit me arsyetimin se nuk është realizuar marrja në pyetje nga ana e gjykatës e personit të arrestuar brenda afatit 3-ditor, të parashikuar nga neni 248/1, i K. Pr. Penale.

15.2.2 Ndërkohë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. ***, datë **.11.2012, kishte vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga i arrestuari ***.*** kundër vendimit nr. **, datë **.7.2012, të Gjykatës së Apelit Vlorë, vendim i cili kishte vendosur miratimin e ekstradimit të shtetasit ***.*** drejt Republikës së Italisë.

15.2.3 Nga hetimi gjyqësor, ka rezultuar se Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. **, datë **.2.2014, ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. ***, datë **.11.2012, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë¹⁵. Nga rezultatet e

¹³ Vendimi nr. ***, datë **.7.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Vlorë.

¹⁴ Pas ekzekutimit të vendimit nr. ***, datë **.10.2012, të Gjykatës së Apelit Vlorë, që kishte vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë **.8.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Vlorë, duke u rrezuar kërkesën e shtetasit ***.*** për revokimin e masës së sigurimit “Arrest në burg për qëllime ekstradimi”.

¹⁵ Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. **, datë **.2.2014, ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. ***, datë **.11.2012, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë me arsyetimin se: [...] *kërkuesi, duke mos marrë përgjigje për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese, i është mohuar e drejta e ankimit në kuptimin substancial, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës dhe, në këtë kuptim, kërkesa e tij është e bazuar dhe duhet pranuar [...]. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. ***(**), datë **.5.2015, ka vendosur prishjen e vendimit nr. **, datë **.7.2012, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë **.6.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Vlorë, duke arsyetuar se për shtetasin ***.*** kanë filluar dy procedime penale në përfundim të të cilave është deklaruar fajtor*

hetimit, gjithashtu, rezulton se, sipas vërtetimit të datës **.7.2014, të lëshuar nga Kancelari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Vlorë, dosja gjyqësore që i përket vendimit nr. ***, datë **.6.2012, me kërkesë Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Vlorë, me objekt shqyrtimin për ekstradim ndaj shtetasit ***.***, ndodhej për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

15.2.4 Subjekti i rivlerësimit me vendimin nr. ***, datë **.7.2014, ka vendosur pranimin e kërkesës, revokimin (shuarjen) e masës së sigurimit “arrest me burg”, të caktuar ndaj shtetasit ***.***, me vendimin nr. ***, datë **.5.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Vlorë, i lënë në fuqi nga vendimi nr. ***, datë **.10.2012, i Gjykatës së Apelit Vlorë, duke urdhëruar lirimin e tij, nëse nuk mbahet i arrestuar apo i ndaluar për kryerjen e ndonjë veprë tjetër penale.

15.2.5 Në arsyetimin e vendimit, subjekti, ndër të tjera, përsërit dhe një herë arsyetimin e tij në vendimin nr. ***, datë **.8.2012, duke shtuar se: [...] *shfuqizimi i vendimit nr. ***, datë **.11.2012, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. **, datë **.2.2014, të Gjykatës Kushtetuese, ipso lege, ka rihyrë në fuqi urdhri i datës **.7.2012, i Kryetares së Gjykatës së Lartë për pezullimin e vendimit nr. **, datë **.7.2012, të Gjykatës së Apelit Vlorë, për pasojë procedura e ekstradimit ndaj shtetasit ***.*** ende nuk rezulton të ketë përfunduar, jo vetëm për shkak të faktit se vendimi nr. **, datë **.7.2012, i Gjykatës së Apelit Vlorë, në kuptimin material nuk është një vendim gjyqësor i formës së prerë, por edhe nisur nga fakti se ...procedura e ekstradimit do të konsiderohet e përfunduar vetëm atëherë kur ezaurohen të gjitha shkallët e ankimit gjyqësor nga kërkuesi...”. Më pas arsyeton se: “...në kushtet kur procesi i themelit të ekstradimit të shtetasit ***.*** drejt Republikës së Italisë, është ende i regjistruar në Gjykatën e Lartë dhe nuk ka përfunduar ende, si dhe në kushtet kur tashmë kanë kaluar më shumë se 3 (tre) muaj nga momenti i fillimit të ekzekutimit të masës shtrënguese “Arrest në burg” ndaj tij (**.4.2012), atëherë masa e sigurimit “Arrest në burg”, e ekzekutuar ndaj tij në datën **.2.2014, në kuptim të nenit 493 të K. Pr. Penale, e ka humbur fuqinë e saj dhe, për pasojë, ajo duhet revokuar [...].*

15.2.6 Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë **.8.2014, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë **.7.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Vlorë, rrëzimin e kërkesës së kërkuetit ***.***, duke arsyetuar se interpretimi ligjor i nenit 493/4, i Kodit të Procedurës Penale kërkon, detyrimisht dhe domosdo, përfundimin e shqyrtimit të kërkesës për ekstradim nga autoritetet gjyqësore, ku përfshihen Gjykata e Shkallës së Parë dhe Gjykata e Apelit. Më pas vijon me arsyetimin se: [...] *Shfuqizimi i vendimit nr. ***, datë **.11.2012, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. **, datë **.2.2014, të Gjykatës Kushtetuese, duke e kthyer çështjen për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë, nuk i cenon efektet e vendimit të formës së prerë të Gjykatës së Apelit, pasi ...pezullimi i ekzekutimit i vendimit të formës së prerë nr. **, datë **.7.2012, nga Kryetarja e Gjykatës së Lartë... nuk ka ndikuar mbi masën e sigurimit të vendosur për të garantuar ekstradimin e kërkuetit. Në rrethanat kur procedimi ka përfunduar brenda afateve të parashikuara nga ligjvënësi, nuk mund të kemi shuarje të masës së sigurimit në referim ligjor me afatet e parashikuara në nenin 493/4, të K. Pr. Penale [...].*

15.2.7 Në vijim, Gjykata e Apelit ka theksuar se kërkesa aktuale në shqyrtim ka qenë objekt shqyrtimi nga Gjykata e Shkallës së Parë dhe Gjykata e Apelit Vlorë, ku kjo e fundit, me vendimin nr. ***, datë **.10.2012, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës

nga gjykatat dhe, për pasojë, konstatohet një nga kushtet ndaluese të nenit 491, të K. Pr. Penale, e cila e ndalon gjykatën të japë ekstradimin, pika c: “kur personi që kërkohet ka kryer një veprë penale në Shqipëri”.

së Parë, Vlorë dhe rrëzimin e kërkesës së kërkuarit ***.*** për revokimin e masës së sigurimit. Pavarësisht se shkaku ligjor i kërkuarit në atë proces ka qenë i ndryshëm, kërkitimi i tij është i njëjtë me kërkesën aktuale për shqyrtim dhe rrethanat e faktit e të ligjit, të vlerësuara nga ajo gjykatë, janë të njëjta me ato që po shqyrtohen aktualisht. Në këto kushte, Gjykata e Apelit ka arritur në përfundimin se: [...] *ndodhemi përpara një vendimi të formës së prerë dhe çështja konsiderohet e mbyllur në bazë të parimit të gjësë së gjykuar, e parashikuar nga neni 34, i Kushtetutës [...].*

15.2.8 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. ***, datë **.9.2014, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuari ***.***, kundër vendimit nr. ***, datë **.8.2014, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

15.2.9 Inspektorati i KLD-së, nga inspektimi i vendimeve të sipërtrajtuara, ka konstatuar se [...] *nga ana e gjyqtarit Laurent Fuçia ka shkelje të normave procedurale penale, konkretisht të nenit 493/4, të Kodit të Procedurës Penale, lidhur me interpretimin “procedim para gjykatës”, por që tashmë në vendimin e dytë të tij, nr.***, datë **.7.2014, ai ka gjykuar një kërkesë, e cila ishte “gjë e gjykuar”, referuar nenit 34 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Pra, gjyqtari Laurent Fuçia ka pasur dijeni të plotë mbi këtë vendimmarrje, kjo edhe për faktin se ka qenë ai, i cili ka dhënë vendimin nr. ***, datë **.8.2012, i ndryshuar me vendimin nr. ***, datë **.10.2012, i administruar edhe në dosjen gjyqësore. Pra ai nuk ka marrë në konsideratë faktin se interpretimi i termit “procedim para gjykatës”, i është dhënë përgjigje me vendimin nr.***, datë **.10.2012, ndërsa ka interpretuar sërish të njëjtin term në ndryshim nga ai i bërë me vendimin e Gjykatës së Apelit, me të cilin ishte ndryshuar vendimmarrja e tij. Pra, ai ka interpretuar në mënyrë të gabuar normën procedurale penale, tashmë edhe në cenim të parimit të “gjësë së gjykuar” [...].*

15.2.10 Komisioni, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin E, të aneksit të Kushtetutës, i kërkoi subjektit shpjegime, pasi duket se subjekti ka marrë vendimin nr. ***, datë **.8.2012, në interpretim të gabuar të nenit 493, pika 4, të Kodit të Procedurës Penale.

15.2.11 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, lidhur me interpretimin e nenit 493/4 të Kodit të Procedurës Penale, është shprehur se në vendimin nr. ***, datë **.7.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Vlorë, është bërë interpretimi pajtues i nenit 493/4 të Kodit të Procedurës Penale në harmoni me qëndrimin e mbajtur nga ana GJEDNJ-së në çështjen *** vs Republika e Shqipërisë, datë **.9.2012, dhe se ka qenë përpara një norme procedurale jo të qartë dhe për të cilën mungonte një interpretim unifikues nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Kjo paqartësi në interpretimin e krijuar ka ardhur si rezultat i parashikimit të mëparshëm të pikës 4, të nenit 493, të Kodit të Procedurës Penale, e cila u zgjidh nga ana e ligjvënësimit me ndryshimet e bëra në këtë dispozitë me ligjin nr. 35/2017. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se ndodhet në kushtet e pikës 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016.

15.2.12 Në përfundim, Komisioni ka arsyetuar se, referuar rrethanave të mësipërme, vendimi objekt shqyrtimi i subjektit të rivlerësimit është zgjidhur nga ky i fundit bazuar në interpretimin e pikës 4, të nenit 493, të Kodit të Procedurës Penale, që ai i ka bërë këtij neni, duke pasur parasysh faktin se deri në atë moment nuk ka pasur një vendim unifikues të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në lidhje me interpretimin e kësaj dispozite. Për këtë arsye, Komisioni

vlerëson se interpretimi i bërë pikës 4, të nenit 493, të Kodit të Procedurës Penale, nga subjekti në vendimet objekt shqyrtimi nuk mund të vlerësohet nga institucionet e rivlerësimit në kuadër të aftësive gjyqësore të tij. Kjo për shkak se vlerësimi i aftësive gjyqësore të subjektit duhet të realizohet pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit, në përputhje me pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016.

15.2.13 Komisioneri Publik, në zbatim dhe të Rekomandimit të ONM-së datë 25.4.2023, si dhe jurisprundencës të Kolegjit, duke arsyetuar mbi të njëjtin prezumim të kufijve të rivlerësimit, të përdorur nga Komisioni, konstaton se të dhënat e rezultuara nga hetimi administrativ në rastin konkret janë të tilla që duhen vlerësuar lidhur me aftësinë profesionale të subjektit të rivlerësimit sipas nënindikatoreve të përcaktuar nga neni 72, i ligjit nr. 96/2016, mbi aftësinë për të interpretuar ligjin, për të përdorur parimet e përgjithshme të së drejtës dhe mbi cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik.

15.2.14 Nga hetimi administrativ rezultoi se subjekti ka marrë jo vetëm vendimin nr. ***, datë **.8.2012, në interpretim të gabuar të normës procedurale penale, por ka disponuar dhe me vendimin nr. ***, datë **.7.2014, në përsëritje të interpretimit të gabuar të nenit 493, pika 4 të K. Procedurës penale, si dhe në cenim të parimit të “gjësë së gjykuar”.

15.2.15 Komisioneri Publik, bazuar edhe në Rekomandimin e ONM-së, datë 25.4.2023, vlerëson se, edhe nëse konsiderojmë pretendimet e subjektit se në kohën e marrjes së vendimit nr. ***, datë **.8.2012, neni 493, pika 4 (para ndryshimeve të vitit 2017), Kodi i Pr. Penale ishte i paqartë lidhur me afatin 3-mujor për revokimin e masës së sigurisë, sërish rezulton se subjekti i rivlerësimit ishte në dijeni të interpretimit të bërë kësaj dispozite, nga gjykatat më të larta, kur mori vendimin nr. ***, datë **.7.2014.

15.2.16 Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë **.10.2012, kishte vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë **.8.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Vlorë, me arsyetim tjetër, dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë mbante të njëjtin qëndrim në vendimin e tij, nr.***, datë **.11.2012, duke refuzuar rekursin e kërkuarit.

15.2.17 Në këto rrethana, në konsideratë edhe të pretendimit mbi paqartësinë e interpretimit të kësaj dispozite në vitin 2012, mbetet i pajustificuar nga subjekti interpretimi i njëjtë i kësaj dispozite, në vendimin e vitit 2014, pa marrë në konsideratë arsyetimet dhe vendimet e mëparshme të Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës së Lartë.

15.2.18 Për më tepër, pavarësisht pretendimeve të subjektit mbi paqartësinë e normës ligjore, konstatohet se keqinterpretimi nga subjekti lidhur me kalimin e afatit 3-mujor ka ndodhur për shkak se subjekti këtë afat e ka lidhur me faktin se akoma nuk kishte një vendim përfundimtar mbi miratimin e ekstradimit (*e cila si procedurë nuk ka të bëjë me aplikimin e nenit 493, pika 4, të K. Pr. Penale, pavarësisht ndryshimeve që kjo dispozite ka pësuar me kohën*) dhe jo me shqyrtimin e kërkesave mbi masat e sigurisë. Në këto rrethana, gjetjet e kësaj çështje bëhen dhe më të nevojshme për t’u vlerësuar, në kuptim të nenit 72, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

16. *Vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Vlorë, dhënë nga subjekti i rivlerësimit: (1) nr. *** akti/nr.*** vendimi, datë **.7.2013, me palë ndërgjyqëse paditës ***.***, i paditur AKKP, Tiranë dhe (2) vendimi nr.***, datë **.10.2013, me palë ndërgjyqëse /paditës ***.***, ***.***; I Paditur ZVRPP, Vlorë.*

16.1 Nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, lidhur me kërkesën për inspektim që Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe Kryeministria kanë paraqitur pranë Ministrisë së Drejtësisë ndaj subjektit të rivlerësimit, mbi dhënien e vendimeve gjyqësore lidhur me procedurat e privatizimit të godinës së ish-Hetuesisë Vlorë, Komisioni ka konstatuar se:

16.2 *Rrethanat e faktit.* Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Vlorë ka gjykuar çështjen civile nr. *** akti, që i përket palëve: Padiës ***.*** (***) ; I paditur AKKP Tiranë; Me objekt: Anulimin e pikës 2, të vendimit nr.***, datë **.6.2009, të ZRKKP Vlorë, duke njohur të drejtën e parablerjes edhe për sip. 93 m² me nr. pasurie ***, vol.**, f.***, të ndodhur në qytetin e Vlorës.

16.3 Nga hetimi gjyqësor ka rezultuar se, me anë të vendimit nr. ***, datë **.6.2009, të AKKP-së Tiranë, është vendosur njohja dhe kthimi i pasurisë me sip. 403 m² si dhe e drejta e parablerjes e sipërfaqes 214 m² në favor të trashëgimtarëve ligjorë të të ndjerit ***.*** dhe rrezimi i kërkesës në lidhje me sip. 93 m², me arsyetimin se kjo sip. është regjistruar në emër të shtetasve *** dhe ***.***. Lidhur me këtë pasuri ka rezultuar se është zhvilluar dhe një proces gjyqësor, ku gjatë gjykimit është konstatuar se është ndërtuar një shtesë kati, e realizuar nga shteti, në objektin e ish-pronarit.

16.4 Gjykata me vendimin nr. ***, datë **.7.2012, ka vendosur pavlefshmërinë e kontratës së privatizimit në emër të shtetasve *** dhe ***.***, si dhe fshirjen e regjistrimit në emër të tyre, duke u regjistruar në favor të shtetit. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë **.5.2013.

16.5 Në kushtet kur kishte rënë shkaku për të cilin nuk i ishte njohur e drejta e parablerjes për sip. 93 m², padiësi ***.***, në cilësinë e trashëgimtarit ligjor të të ndjerit ***.***, ka kërkuar, me anë të padisë drejtuar gjykatës, që t'i njihet e drejta e parablerjes dhe për sip. 93 m² me nr. pasurie ***.

16.6 Subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr.***, datë **.7.2013, ka vendosur pranimin e kërkesëpadiës, anulimin e pjesshëm të vendimit nr.***, datë **.6.2009, të ZRKKP-së Vlorë, vetëm në lidhje me pikën 2 të tij, duke njohur të drejtën e parablerjes në favor të palës padiëse edhe në lidhje me sip. 93 m² me nr. pasurie ***, vol.**, fq.***, z. k. ***, Vlorë. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën **.8.2013, pasi nuk është ankimuar.

16.7 Në vijim, nga hetimi ka rezultuar se po subjekti ka gjykuar çështjen civile nr. *** akti me palë ndërgjyqëse: Padiës ***.***, ***.***; I Paditur ZVRPP Vlorë; Me objekt detyrimin e palës së paditur të regjistrojë sipërfaqen prej 117 m², me nr. pasurie ***, vol.**, f.*** dhe sipërfaqen prej 190 m² me nr. pasurie ***, vol. **, f. ** dhe nr.***, vol. **, f. **, ndodhur në katin e tretë të godinës trekateshe, të quajtur ish-Hetuesia, godina me nr. pasurie ***.

16.8 Nga hetimi gjyqësor ka rezultuar se trashëgimtarët ligjorë të të ndjerit ***.***, me anë të kontratës së shitjes, datë **.8.2012, i kanë kaluar të drejtën reale të parablerjes palës padiëse, *** dhe ***.***, për sipërfaqen prej 214 m² dhe me kontratën e shitjes së datës **.9.2013, të lidhur po midis tyre, padiësit kanë blerë edhe të drejtën e parablerjes për sip. 93 m², të katit të tretë të godinës. Më pas, pala padiëse i është drejtuar ZVRPP-së Vlorë, me qëllim regjistrimin e sipërfaqeve të mësipërme, por ky institucion ka refuzuar regjistrimin, duke i kthyer përgjigje se nuk dispononte dokument ligjor për regjistrim (titull).

16.9 Në përfundim të gjykimit, subjekti me vendimin nr. ***, datë **.10.2013, ka vendosur: [...] *detyrimin e palës së paditur ZVRPP-Vlorë, që të regjistrojë në regjistrat e pasurisë së paluajtshme, në emër të palës paditëse, sipërfaqen prej 117 m², nr. pasurie ***, vol. **, f. ***,... të ndodhur në katin e tretë të godinës trekatëshe, të quajtur ish-Hetuesia, godina nr. pasurie *** [...]. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën **.10.2013, pasi nuk është ankimuar nga palët e thirrura nga gjykata në gjykim.*

16.10 Sa më sipër, Komisioni bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin E, të aneksit të Kushtetutës, i ka kërkuar subjektit të paraqesë shpjegime, pasi duket se subjekti ka marrë vendimin nr. ***, datë **.10.2013, duke mos u mbështetur në provat e paraqitura nga palët në gjykim, sipas parashikimit të nenit 29, të Kodit të Procedurës Civile, pasi nga hetimi gjyqësor ka rezultuar se: (1) pasuria nr. ***, vol. **, f. ***, z. k. ***, Vlorë, është shtesë kati i realizuar nga shteti në objektin e ish-pronarit, dhe për këtë pasuri nuk është realizuar asnjë procedurë privatizimi nga organet shtetërore, si mbajtës të titullit të pronësisë dhe (2) në kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.9.2013, pala shitëse i ka kaluar palës paditëse të drejtën e parablerjes dhe të kompensimit, dhe jo të drejtën e pronësisë të sip. ndërtimore 93 m,² me nr. pasuri ***.

16.11 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ndër të tjera, është shprehur se: [...] *sa i përket vendimit civil nr.***, datë **.10.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Vlorë, ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, gjykoj se një vendim i tillë është rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit të drejtë të ligjit material civil, si dhe e vlerësimit dhe e çmuarjes së drejtë të provave të marra në shqyrtim në këtë gjykim. E drejta e parablerjes është një e drejtë reale dhe si e tillë mund të disponohet lirisht nga pronari përmes kontratës së dhurimit ose të shitjes, sikundër ka ndodhur në rastin konkret. Një konkluzion i tillë gjen mbështetje edhe në vendimin unifikues civil nr.23, datë 01/2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas së cilit: “Edhe e drejta e kompensimit të ish-pronarëve, sipas ligjit nr.7698, datë 15.4.1993, duhet të konsiderohet si një e drejtë reale e vendosur me ligj. Duke qenë e tillë, ajo mund të disponohet me anë të dhurimit prej titullarit të saj [...].*

16.12 Komisioni, ka çmuar se: [...] *vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit për detyrimin e ZVRPP-së të regjistrojë pasurinë nr. ***, vol. **, f. ***, në pronësi të paditësve ***. dhe ***. ***, duke arsyetuar, ndër të tjera, se gjykata çmon se palës paditëse i ka lindur e drejta për të kërkuar regjistrimin e pasurisë objekt gjykimi... në kushtet kur ajo arriti të provojë përpara gjykatës jo vetëm titullin e saj të pronësisë mbi sendin, por edhe origjinën e krijimit të këtij titulli, e konkretisht pala paditëse ka fituar pronësinë në lidhje me këtë pasuri sipas kontratës së shitjes datë **.9.2013, përbën një mangësi në arsyetim dhe vlerësim jo të drejtë nga ana e subjektit të njohurive ligjore [...].*

16.13 Në përfundim, Komisioni vlerësoi se kjo çështje duhet të transferohet në bazë të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, pranë organit kompetent për inspektim, për të verifikuar nëse evidentohen shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore, sipas ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ose nëse ka shkaqe për t’u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të subjektit të rivlerësimit.

16.14 Komisioneri Publik, përpara se të vijojë me trajtimin e çështjes objekt ankimi dhe për të cilat Kolegji do të duhet të shprehet në zbatim të juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të tij, çmon të vendosë paraprakisht në konsideratë jurisprudencën orientuese të Kolegjit, në lidhje

me rastet e praktikave të transferuara, për të cilat, ndër të tjera, është shprehur se: [...] *praktikat të cilat transferohen për inspektim në organet kompetente, në parim duhet të përmbajnë shkelje joserioze, pa pasoja të rënda procedurale për palët, brenda afateve të parashikuara në nenin 117, të ligjit nr. 96/2016*¹⁶[...].

16.15 Në këto rrethana, Komisioneri Publik vlerëson se çështja e transferuar nga Komisioni, që i përket vitit 2013, është jashtë afatit 5-vjeçar nga koha kur ka ndodhur shkelja e pretenduar, të parashikuar nga neni 117 i ligjit nr. 96/2016. Në këto rrethana, kjo çështje, për shkak të afatit të parashkrimit, përjashtohet nga mundësia që të vlerësohet nga organi kompetent për shkelje disiplinore, si dhe duke i shkëputur nga gjetjet e tjera të rezultuara nga vlerësimi i burimeve të kriterit profesional, e përjashton atë dhe nga vlerësimi në funksion të procesit të rivlerësimit.

16.16 Komisioneri Publik, në analizë të akteve të administruara lidhur me vendimin nr. ***/2013, të marrë nga subjekti i rivlerësimit, si dhe Rekomandimit të ONM-së, datë 25.4.2023, vëren se në rastin konkret, duket se qëllimi i subjektit në vendimmarrjen e tij ka qenë regjistrimi i pronësisë në regjistrat e pasurisë së paluajtshme, në emër të palës paditëse z. ***.**, dhe jo njohjen e të drejtës së parablerjes, siç ka pretenduar subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetjes së përfaqësuesit të ONM-së, vetëm gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore.¹⁷

16.17 Pretendimet e subjektit nuk mbështeten as nga kërkimet e objektit të padisë: [...] *Detyrimi i palës së paditur të regjistrojë sipërfaqen prej 117 m² me nr. pasurie ***, vol. **, f.***... ndodhur në katin e tretë të godinës trekatëshe, të quajtur ****, godina nr. pasurie *** [...], dhe as dhe nga përmbajtja e vendimit, në të cilën subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, arsyeton se: [...] *Gjykata çmon se, palës paditëse i lind e drejta për të kërkuar regjistrimin e pasurisë objekt gjykimi në regjistrat e pasurive të paluajtshme, në kushtet kur ajo arriti të provojë përpara gjykatës, jo vetëm titullin e saj të pronësisë mbi sendin, por edhe origjinën e krijimit të këtij titulli, e konkretisht pala paditëse e ka fituar pronësinë në lidhje me këtë pasuri (307 m²), sipas kontratës së shitjes të së drejtës reale, datë **.8.2012 (214 m²) dhe kontratës së shitjes datë **.9.2013, lidhur midis saj dhe trashëgimtarëve ligjore të të ndjerit ***.***... Në kushtet kur regjistrimi i pasurisë realizohet nga regjistruesi, sipas parashikimit të nenit 45 të ligjit, në prezencë të një akti administrativ apo veprimi juridik për fitimin e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, dhe gjithmonë pas plotësimit të kushteve të nenit 193/a të Kodit Civil, gjykata çmon se pala paditëse disponon titullin për regjistrimin e pronësisë [...].**

16.18 Po ashtu, subjekti i rivlerësimit, në arsyetimin e vendimit nr. ***/2013, shprehet se: [...] *Pala paditëse ka interes të ligjshëm në paraqitjen e padisë, sepse në cilësinë e titullares të së drejtës së pronësisë, ajo kërkon regjistrimin e saj në regjistrat e pasurisë së paluajtshme, fakt i cili i mundëson asaj ushtrimin e qetë të tagrave të pronësisë, duke përfshirë këtu edhe tagrin e disponimit mbi sendin [...], duke urdhëruar në vendimmarrje, ndër të tjera [...] detyrimin e palës së paditur ZVRPP Vlorë, që të regjistrojë në regjistrat e pasurisë së paluajtshme, në emër të palës paditëse, sipërfaqen prej 117 m² [...].*

16.19 Subjekti i rivlerësimit, në vendim i referohet nenit 193/a, të K. Civil, i cili parashikon regjistrimin në regjistrin e pasurive të paluajtshme, kontratat për kalimin e pronësisë së sendeve

¹⁶ Referohuni vendimit (JR) nr. 2/2020, prg. 32.5, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

¹⁷ Në faqen 10 të Rekomandimit të ONM-së, referohet se me kërkesë të përfaqësuesit të ONM-së, gjatë seancës gjyqësore, subjekti u përgjigj se vendimi nr. ***/2013, ka urdhëruar ZVRPP-në Vlorë, të regjistrojë të drejtën reale të parablerjes dhe jo të drejtën e pronësisë mbi sipërfaqen.

të paluajtshme dhe aktet për pjesëtimin vullnetar të tyre, dhe ka për qëllim kalimin e pronësisë, dhe nuk referon nenin 193/b, i cili parashikon regjistrimin në regjistrin e pasurive të paluajtshme të kontratave me të cilat krijohen, njihen, ndryshohen ose pushojnë të drejta pronësie mbi sendet e paluajtshme, të drejta uzufukti, përdorimi e bujtjeje, emfiteoze e servituti e të drejta të tjera reale.

16.20 Si përfundim, për sa administruar në dosje të Komisionit dhe arsyetuar gjerësisht dhe në Rekomandimin e ONM-së, datë 25.4.2023¹⁸, pjesë e këtij ankimi, rezulton se subjekti ka dhënë një vendim të pabazuar në ligj dhe prova, si dhe ka urdhëruar regjistrimin e titullit të pronësisë në favor të z. ***, ndërkohë që ky titull pronësie nuk ka kaluar fillimisht nga *pronari shtet* te palët e treta¹⁹. Ky qëndrim mbështetet dhe nga vendimi nr. ***-2018-***, datë **.1.2018, i Gjykatës Administrative të Apelit²⁰, nga i cili rezulton se, ndër të tjera, vendimi nr. ***/2013, i dhënë nga subjekti i rivlerësimit, ka sjellë pasoja të rënda dhe për shumë palë të përfshira të proces.

16.21 Përfaqësuesit e ONM-së, duke konsideruar se ky rast është adresuar jo vetëm nga institucione publike, por dhe nga organet ligjzbatuese, vënë në dukje se sjellja e subjektit të rivlerësimit, gjatë shqyrtimit të kësaj çështje, ngre dyshime, mbi integritetin e tij, në funksion të nenit 75, pika 3 të ligjit nr. 96/2016²¹. Në vijim të qëndrimit të përfaqësuesve të ONM-së, lidhur me konstatimet e organeve të tjera ndihmëse të procesit, Komisioneri Publik çmon t'i sjellë në vëmendje Kolegjit se, pavarësisht korrespondencës së mëvonshme, mungon të jetë administruar nga DSIK-ja një raport për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, në formatin e kërkuar nga ligji, duke marrë si provë përgjigjen e të gjitha organeve ndihmëse, përfshirë autoritetin verifikues SHISH, në përputhje me parashikimet e kreut V, të ligjit nr. 84/2016.

16.22 Komisioneri Publik, bazuar në Rekomandimin e ONM-së, datë 25.4.2023, jurisprudencën e Kolegjit, si dhe vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, vlerëson se gjetjet e rastit konkret janë të një natyre të rëndë, serioze dhe me pasoja për palët dhe, si i tillë, ky vendim nuk duhej transferuar, por duhet të vlerësohej së bashku me gjetjet e tjera, në kuptim të nenit 72, pika 2 dhe 3, të ligjit nr. 96/2016.

17. (2) Raste që paraqesin një seri të qartë dhe të vazhdueshme të gjykrimeve të gabuara

18. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, në datën **.1.2014, ka paraqitur kërkesën për inspektim pranë Ministrisë së Drejtësisë, duke pretenduar se gjyqtari Laurent Fuçia ka gjykuar çështjen civile me palë: Padiës ***.***; I paditur AKKP Tiranë; me objekt anulimin e pikës **, të vendimit nr.***, datë **.6.2009, të ZRKK-së Vlorë, duke njohur të drejtën e parablerjes edhe për sip. 93 m,² me nr. pasurie ***, vol.**, f.***, të ndodhur në qytetin e Vlorës, të përfunduar me vendimin nr. *** akti/nr.*** vendimi, datë **.7.2013, brenda një afati të pazakontë edhe në raport me praktikën, brenda 2 seancave. Në vijim të këtij *iteri* të përshpejtuar, konstatohet se subjekti nuk ka njoftuar Avokaturën e Shtetit për të marrë pjesë në

¹⁸ Referohuni arsyetimit të Rekomandimit, f. 11-12 të tij.

¹⁹ Rekomandimi vë në dukje se Bashkia Vlorë nuk është thirrur si palë në cilësinë e subjektit që i ka kaluar e drejta e privatizimit të sendit dhe të pronarit "shtet" mbi pasurinë. Po ashtu, nuk u thirrën trashëgimtarët e familjes ***, në cilësinë e mbajtësit të së drejtës reale ose familja ***, të cilët posedonin për vite këtë pasuri.

²⁰ Referohuni akteve Prokurori + Gjykata/ Vendime nga sistemi gjykata.gov.al, në dosje të Komisionit.

²¹ Referohuni f.12 të Rekomandimit, lidhur me referencën nr.7, ku citohet vendimi (JR) nr.16/2021, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me subjekt ***.***.

gjykim në kundërshtim me nenin 79/a, të K. Pr. Civile, vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.13, datë 24.3.2004, si dhe vendimin nr. 42, datë 29.9.2011, të Gjykatës Kushtetuese.

18.1 Gjithashtu, konstatohet se nga ana e institucionit të Kryeministrit, pas ushtrimit të kontrollit administrativ lidhur me procedurat e privatizimit të godinës së ***, Vlorë (*që ishte objekt i gjykimit të mësipërm*), është paraqitur ankesë pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe KLD-së ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Vlorë, Laurent Fuçia, lidhur me dhënien e vendimeve gjyqësore *(1) nr. *** akti/ nr.*** vendimi , datë **.7.2013 dhe (2) nr. **, datë **.10.2013*²², duke pretenduar se gjykimi i këtyre çështjeve është bërë në shkelje të procedurave, duke mos u thirrur si palë në gjykim Avokatura e Shtetit.

18.2 Inspektorati i KLD-së, pas inspektimit, ka konstatuar se vendimi nr. *** akti/ nr.*** vendimi, datë **.7.2013, ka marrë formë të prerë në datën **.8.2013 dhe vendimi nr. **, datë **.10.2013, ka marrë formë të prerë në datën **.10.2013, duke mos u ankimuar. Në kushtet ku palë në këto gjykime ishin AKKP Tiranë dhe ZVRPP Vlorë, institucione në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, KLD i ka përcjellë për kompetencë ankesat e mësipërme Ministrisë së Drejtësisë.

18.3 Ministria e Drejtësisë, në përfundim të inspektimit, pasi ka administruar dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti, për rastet konkrete, ka konkluduar se: [...] *(1) Në çështjen civile të përfunduar me vendimin nr.***, datë **.7.2013, gjyqtari Laurent Fuçia: a) nuk ka respektuar detyrimin ligjor të parashikuar nga neni 79/a i K. Pr. Civile dhe nga neni 5, pika “b”, të ligjit nr.10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, pasi nuk ka njoftuar Avokaturën e Shtetit për të marrë pjesë në gjykimin e një çështjeje civile, ku ishte palë një organ i administratës shtetërore; dhe b) nuk ka respektuar detyrimin ligjor të parashikuar nga neni 18 i ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, i ndryshuar, pasi kjo çështje është gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Vlorë, ndërkohë që gjykata kompetente në aspektin tokësor është Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë; (2) Në çështjen civile të përfunduar me vendimin nr. **, datë **.10.2013, gjyqtari Laurent Fuçia nuk ka respektuar detyrimin ligjor të parashikuar nga neni 155, paragrafi i parë i K. Pr. Civile, pasi ka planifikuar seancën përgatitore pas shtatë ditësh [...].*

18.3.1 Ministria e Drejtësisë, me shkresën nr. *** prot., datë **.2.2016, konstatimet e mësipërme i ka përcjellë Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me qëllim vlerësimin/konsiderimin e tij gjatë procedurës së vlerësimit të gjyqtarit Laurent Fuçia. Në vijim, Komisioni i ka kërkuar subjektit të jap shpjegime lidhur me konstatimet e Ministrisë së Drejtësisë.

18.4 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, u shpreh se:²³ [...] *vlerësoj dhe gjykoj se, pavarësisht këtij parashikimi ligjor, nga interpretimi sistematik i dispozitave procedurale civile, nga referimi në doktrinën e së drejtës procedurale civile, si dhe nga studimi i praktikës gjyqësore në këtë fushë, ende nuk rezulton të jetë definuar përfundimisht dhe ka konfuzione në lidhje me pozicionin procedural të Avokaturës së Shtetit, në një gjykim civil, ku pjesëmarrja e saj është e detyrueshme sipas ligjit. Gjykoj se, duke u nisur nga sa sipër, një shkelje e tillë*

²² Vendim nr. ***, datë **.10.2013. Paditës, z. *** ***, e paditur ZVRPP Vlorë, me objekt: *Detyrimin e palës së paditur të regjistrojë sipërfaqen ndërtime dhe shkallëve dhe sipërfaqes së truallit nën të, që ndodhet ngjitur me pasurinë me nr.***, vol. **, f.***, e ndodhur në z. k. ***.*

²³ Referohuni rapërtimeve të subjektit të rivlerësimit, datë 23.2.2023.

procedurale, në aspektin objektiv, referuar nenit 135 të Kushtetutës, si dhe parimit kushtetues të kontrollit të vendimeve të gjykatës më të ulët vetëm nga gjykata më e lartë, mund dhe duhet të përbëjë lëndë ankimi për gjykatën më të lartë, në drejtim të kontrollit në fakt dhe ligj të vendimmarrjes së gjykatës më të ulët, në rastin konkret, Gjykatës së Shkallës së Parë [...].

18.5 Sa më sipër, në analizë të fakteve të rezultuara nga hetimi administrativ dhe të shpjegimeve të subjektit, Komisioni çmoi se mosnjoftimi i institucionit të Avokaturës së Shtetit gjatë procesit përbën cenim të procesit të rregullt ligjor, kjo në referencë të vendimit unifikues nr. 13, datë 24.3.2004, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese.

18.6 Komisioneri Publik, në zbatim edhe të Rekomandimit të ONM-së datë 25.4.2023, vlerëson se gjetjet e lartlistuara qëndrojnë, veçanërisht lidhur me detyrimin që subjekti kishte për të njoftuar Avokaturën e Shtetit, detyrim i parashikuar si nga e drejta procedurale, ashtu dhe nga ligji i posaçëm mbi Avokaturën e Shtetit.

19. Ankesa e shtetasit *.*****

19.1 Shtetasit ***.***, ***.***, ***, ***, ***, ***, ***, ***, të përfaqësuar nga shtetasi ***.***, në datën **.4.2014, kanë paraqitur ankim përpara KLD-së, duke pretenduar se gjyqtari Laurent Fuçia, në vendimin nr. *** akti, datë **.3.2014, nuk ka pasqyruar faktin juridik se pala e paditur, ***.*** etj., gjykoheshin në mungesë, gjë që ka sjellë humbjen e të drejtës për të paraqitur rekurs dhe ka detyruar ankuesin të paraqesë kërkesë në gjykatë për të rivendosur në afat të drejtën e tij për të paraqitur rekurs.

19.2 *Rrethanat e faktit.* Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Vlorë, ka gjykuar çështjen civile me palë: Paditës ***.***; Të paditur ***.***, ***.*** etj. dhe ZVRPP Vlorë, AKKP, Tiranë; Me objekt: *Ndryshimin e vendimit nr.***, datë **.6.2009, të ish-ZR KKP Vlorë, duke kthyer në natyrë sipërfaqen prej 30.222,5 m². Kundërshtim akti të marrjes së tokës në pronësi, dhënë në emër të ***.***, detyrim njohje pronar, detyrimin e ZVRPP-së Vlorë të çregjistrojë pronën nga shtetasi ***.***, dhe ta regjistrojë në emër të trashëgimtarëve ligjorë të subjektit të shpronësuar, ***.***.*

19.3 Fillimisht, palët e paditura në seancë gjyqësore kanë kërkuar përjashtimin e gjyqtarit Laurent Fuçia nga gjykimi i çështjes. Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Vlorë, me vendimin nr.***, datë **.2.2014, me tjetër trup gjykues, ka vendosur rrëzimin e kërkesës.

19.4 Në vijim rezulton se subjekti i rivlerësimit me vendimin nr. *** akti, datë **.3.2014, ka vendosur: [...] (1) *Veçimin e objektit të padisë, që konsiston në kundërshtimin e aktit të marrjes së tokës në pronësi dhënë në emër të ***.**** (2) *Shpalljen e moskompetencës lëndore në lidhje me këtë kërkim dhe* (3) *dërgimin e akteve të çështjes nr.*** akti, vetëm sa i takon kërkit administrativ në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Vlorë [...].*

19.4.1 Ky vendim është dhënë nga subjekti pa praninë e palëve, por në vendim nuk pasqyrohet që të paditurit (trashëgimtarët ligjorë të të pandehurit ***.***) gjykoheshin në mungesë, duke sjellë si pasojë moskomunikimin e vendimit të paditurve.

19.5 Të paditurit, pasi janë njohur me këtë vendim, e kanë kundërshtuar, por rekursi i tyre nuk është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Vlorë, për shkak se vendimi kishte marrë formë të prerë, bazuar në aktet për kryerjen e njoftimeve procedurale. Në këto kushte, të

paditurit i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Vlorë, me kërkesë për rivendosje në afat të ankimit (rekursit). Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Vlorë me vendimin nr. ***, datë **.6.2014, ka vendosur pranimin e kërkesës.

19.6 Inspektorati i KLD-së ka konstatuar se: [...] gjyqtari Laurent Fuçia ka vepruar në shkelje të dispozitave procedurale kur ka bërë gjykimin në datën **.3.2014 pa thirrur palët ndërgjyqëse, sepse ai në këtë rast ka qenë në vijim të gjykimit dhe duhej të thërriste seancë gjyqësore, duke njoftuar palët ndërgjyqëse. Kjo vjen në kundërshtim me dispozitat procedurale, që parashikohen në nenin 172 deri në 179 të K. Pr. Civile, sepse nuk mund të zhvillohet gjykimi në mungesë të gjitha palëve ndërgjyqëse pa i thirrur ato në seancë gjyqësore. Gjykimi në mungesë lejohet përjashtimisht vetëm në kushtet që parashikohen në nenin 179 të K. Pr. Civile, kur pala e paditur apo personi i tretë nuk janë paraqitur pa shkak të arsyeshem, megjithëse janë njoftuar rregullisht [...]. Bazuar në këto gjetje, Inspektorati ka sugjeruar t'i tërhiqet vëmendja me shkrim gjyqtarit Laurent Fuçia, për mosrespektim formal të ligjit, duke u bërë kjo pjesë përbërëse e dosjes së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit.

19.7 Komisioni, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin E, të aneksit të Kushtetutës, i ka kërkuar subjektit të paraqesë shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit, pasi ka rezultuar se subjekti ka zhvilluar seancën e datës **.3.2014 pa njoftuar palët dhe, rrjedhimisht, në mungesë të tyre, duke moszbatuar nenet 175 dhe 179, të Kodit të Procedurës Civile.

19.8 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, në shpjegimet e tij ka deklaruar²⁴se: [...] në pjesën hyrëse të vendimit për veçimin e çështjes dhe shpalljen e moskompetencës lëndore, janë shënuar palët e paditura dhe personat e tretë që kanë qenë në mungesë gjatë gjykimit dhe nuk është shënuar e njëjta pozitë për palën paditëse të kundërpaditur, për arsye se, së pari, në gjykimin në shkallë të parë paditësi nuk mund të kishte pozitën procedurale të palës në mungesë (para ndryshimeve të nenit 179 të K. Pr. Civile) dhe së dyti, në kushtet kur marrja e vendimit është bërë në dhomë këshillimi, është e kuptueshme që pala paditëse nuk mund të vendosej si e pranishme në vendim [...].

19.9 Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar²⁵se subjekti ka treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin, sipas parashikimit të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

19.10 Komisioneri Publik, në zbatim edhe të Rekomandimit të ONM-së datë 25.4.2023, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me mangësitë e konstatuara. Duke qenë se vendimi nr. ***, datë **.3.2014, është vendim i ankimeshem, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin të njoftonte palët. Subjekti i rivlerësimit nuk ka njoftuar palën në proces dhe ka zhvilluar seancën gjyqësore në shkelje të neneve 17, 172, 175 dhe 179 të Kodit të Procedurës Civile²⁶.

²⁴ Referohuni prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, datë 23.2.2023.

²⁵ Referohuni vendimit të Komisionit, prg. 69, f. 45.

²⁶ **Neni 17:** Gjykata fton palët që të japin shpjegime nga pikëpamja e së drejtës që ajo e çmon të nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes; **Neni 172:** Shqyrtimi i çështjes përpara gjykatës bëhet verbalisht, por palët mund të parashtrojnë me shkrim shpjegimet dhe pretendimet e tyre rreth çështjes në gjykim. Shpjegimet dhe pretendimet me shkrim të paraqitura nga palët, në mbështetje të kërkesave dhe konkluzioneve të tyre, bëhen pjesë e dosjes gjyqësore, ose i bashkohen procesverbalit kur ai mbahet me shtypshkrim apo dorëshkrim. **Neni 175:** "Pasi deklarohet çelja e seancës gjyqësore, gjykata verifikon paraqitjen e palëve dhe heton shkaqet kur njëra ose të dyja ato nuk janë paraqitur në seancë. Në rast se mosparaqitja ka ndodhur për

20. Ankesa e shoqërisë “**** ****” sh.a.

20.1 Ish-shoqëria “**** ****” sh.a., në datën **.12.2013, ka paraqitur ankesë drejtuar KLD-së kundër gjyqtarit Laurent Fuçia për mënyrën e parregullt të zhvillimit të proceseve gjyqësore, ku kjo shoqëri ka qenë në cilësinë e të paditurit.

20.2 (1) Lidhur me procesin gjyqësor civil të përfunduar me vendimin nr. ***, datë **.7.2013, rasti i familjes ***

20.2.1 Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Vlorë është gjykuar çështja civile me palë: Padi tës ***.***, ***.***; I paditur “**** ****” sh.a.; me objekt: Shpërblimin e dëmit pasuror, jopasuror lidhur me vdekjen e shtetasve *** dhe ***.***. Padia është paraqitur në gjykatë në datën **.7.2013.

20.2.2 Subjekti me vendimin nr.***, datë **.7.2013, ka vendosur: [...] (1) Pranimin e kërkesëpadisë, (2) Detyrimin e palës së paditur “**** ****” të dëmshpërblejë palën padi tëse ***.***, dhe ***.***., në shumën 24.000.000 lekë, (dëm biologjik, moral dhe ekzistencial), përfshirë dhe kamatat... duke filluar nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë deri në datën e ekzekutimit të vendimit [...]. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. **, datë **.4.2014. Gjykata e Lartë me vendimin nr.***-2014-***, datë **.7.2014, ka vendosur mospranimin e rekursit.

20.2.3 Inspektorati i KLD-së ka konstatuar se pala e paditur është njoftuar për padinë dhe seancën përgatitore të datës **.7.2013, me anë të fletëthirrjes së datës **.7.2013, pra për 4 ditë, duke u caktuar një afat i shkurtër, që cenon atë caktuar nga ligji e që përbën shkelje procedurale, që ka të bëjë me mosrespektim formal të ligjit, pasi në nenin 155 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se: “Ndërmjet datës që është njoftuar padia dhe asaj të paraqitjes në gjykatë, duhet të sigurohet një afat jo më pak se 10 ditë”.

(i) Gjithashtu, Inspektorati i KLD-së ka konstatuar se: [...] subjekti në seancën përgatitore të datës **.7.2013 ka marrë vendimin e ndërmjetëm për shqyrtimin e çështjes në mungesë të palës së paditur dhe se ky veprim përgatitor që nuk është i mbështetur në nenin 158/a, të Kodit të Procedurës Civile ...lidhur me pasojat juridike të mosparaqitjes së palëve, në paragrafin e dytë të nenit 179 të K. Pr. Civile parashikohet se: “Nëse i padituri nuk paraqitet në seancën e parë dhe padi tësi nuk kërkon që gjykimi të zhvillohet në mungesë, gjykata cakton një seancë tjetër gjyqësore”. Gjithashtu, gjykata, në kundërshtim me kërkesat e nenit 179, të K. Pr. Civile, nuk ka njoftuar të paditurin **** **** sh.a. për zhvillimin e seancave gjyqësore të datës **.7.2013 dhe të datës **.7.2013, por është mjaftuar me njoftimin e tij vetëm për seancën përgatitore të datës **.7.2013, seancë në të cilën ka vendosur shqyrtimin e çështjes në mungesë të kësaj pale. Në këto rrethana ...mosnjoftimi i palës së paditur për zhvillimin e dy seancave gjyqësore përbën mosrespektim formal të ligjit [...].

(ii) Në vijim, inspektorati i KLD-së ka konstatuar se në seancën gjyqësore të datës **.7.2013, subjekti ka vendosur të thërrasë dy ekspertë të kërkuar nga pala padi tëse me emra konkretë. Miratimi i ekspertëve dhe thirrja e tyre në mungesë të palës së paditur, konkludon

shkak sëmundeje ose për ndonjë shkak tjetër të ligjshëm, gjykata shtyn gjykimin për një ditë tjetër”; **Neni 179:** “Nëse padi tësi ose asnjë nga palët, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqiten, si në veprimet përgatitore, ashtu edhe në seancën gjyqësore dhe rezulton se kanë dijeni rregullisht, gjykata apo gjyqtari i vetëm vendos pushimin e gjykimit”.

inspektorati, përbën shkëlqje të nenit 225, të Kodit të Procedurës Civile, i cili përcakton se: “Caktimi i ekspertit bëhet nga gjykata, duke marrë edhe mendimin e palëve e të pjesëmarrësve në gjykim...”, po kështu dhe të nenin 227, që përcakton se: “Gjykata, pasi merr edhe mendimin e palëve, i cakton ekspertit çështjet për të cilat duhet të merret mendimi i tij”.

20.2.4 Ankesa dhe konstatimet e mësipërme i janë përcjellë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Ky organ me vendimin nr. *** prot., datë **.9.2022, ka vendosur: arkivimin e ankesës së shoqërisë “*** ***” sh.a., me arsyetimin se procedimi disiplinor ndaj gjyqtarit është parashkruar sipas nenit 34, pika 2 të ligjit nr. 9877/2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” si dhe të nenit 117, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

20.2.5 Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin E, të aneksit të Kushtetutës, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, pasi duket se: [...] (i) vendimi i ndërmjetëm i subjektit për shqyrtimin e çështjes në mungesë të palës së paditur në seancën përgatitore të datës **.7.2013, nuk mbështetet në nenin 158/a të Kodit të Procedurës Civile, pasi ky vendim sipas nenit 179, të Kodit të Procedurës Civile, merret në seancë gjyqësore, (ii) subjekti nuk ka njoftuar të paditurin për zhvillimin e seancave gjyqësore të datës **.7.2013 dhe të datës **.7.2013, duke moszbatuar nenin 130, të Kodit të Procedurës Civile; (iii) subjekti ka marrë vendimin për thirrjen e dy ekspertëve në mungesë të palës së paditur dhe pa marrë mendimin e saj, duke moszbatuar nenet 225, 227, të Kodit të Procedurës Civile [...].

20.2.6 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, është shprehur se:²⁷ [...] Sqarohet se, për këtë situatë procedurale, ka pasur dy praktika të ndryshme, ku njëra prej të cilave ka qenë ajo sipas së cilës, në rastet kur pala e paditur deklarohej në mungesë në seancën e veprimeve përgatitore, nuk procedohej më me njoftimin e saj në vijim për seancat gjyqësore. Ky qëndrim është mbajtur nga ana ime edhe si rezultat i diskutimeve të natyrës juridike me kolegë të tjerë magistratë, që ndanin të njëjtin mendim. Sa i përket pretendimit të subjektit ankues në lidhje me mosnjoftimin nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë të vendimit të ndërmjetëm për kryerjen e akteve të ekspertimit dhe thirrjen e ekspertëve, vlerësoj se një pretendim i tillë është i pabazuar në ligjin procedural civil, për arsye se kryerja e një veprimi të tillë procedural nuk është aspak i detyrueshëm për gjykatën. Përveç sa sipër, rezulton e provuar se vendimi në fjalë është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr.***, datë **.4.2014, për pasojë ndodhemi një vendimin gjyqësor të formës së prerë, i cili në kuptim të nenit 451/a të K. Pr. Civile, është i detyrueshëm për gjykatën që ka dhënë vendimin, për palët dhe trashëgimtarët e tyre, si dhe për çdo institucion tjetër shtetëror (res judicata)[...].

20.2.7 Komisioni, në përfundim, vlerësoi se subjekti ka treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin, sipas parashikimit të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

20.2.8 Komisioneri Publik, në zbatim edhe të Rekomandimit të ONM-së, datë 25.4.2023, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me mangësitë e konstatuara.

²⁷ Referohuni prapësisht të subjektit të rivlerësimit, datë 23.2.2023.

20.3 (2) Lidhur me kërkesën e shoqërisë “*** **” sh.a. për përjashtimin e gjyqtarit ***.*** nga gjykimi i çështjes civile, të përfunduar me vendimin nr.***, datë **.10.2013

20.3.1 Referuar akteve në dosje të Komisionit, rezulton se shoqëria “*** **” sh.a. i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Vlorë, me kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit ***.*** nga gjykimi i një çështje civile ku ajo ishte palë. Kjo kërkesë është gjykuar nga gjyqtari Laurent Fuçia, i cili me vendimin nr.***, datë **.10.2013, ka vendosur pushimin e gjykimit.

20.3.2 Në përmbajtjen e vendimit pasqyrohet se në seancën e datës **.10.2013, Gjykata, pasi deklaroi çeljen e saj dhe verifikoi prezencën e palës kërkuese, konstatoi se nuk është paraqitur dhe rezulton se ishte në dijeni të rregullt për datën dhe orën e seancës, fakt i cili, sipas gjykatës, provohet nga fletëthirrja e datës **.10.2013, në të cilën është vendosur shënimi: “Mori dijeni juristi me tel. për datën dhe orën e gjyqit”.

20.3.3 Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit, duke arsyetuar se pala kërkuese ka pasur dijeni të rregullt për datën dhe orën e zhvillimit të seancës, nuk është paraqitur dhe nuk rezultoi që kjo mosparaqitje të ketë ardhur si rezultat i sëmundjes apo shkakut të ligjshëm, ka vendosur pushimin e gjykimit.

20.3.4 Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin E, të aneksit të Kushtetutës, i ka kërkuar subjektit shpjegime, pasi ka vlerësuar se: [...] *subjekti nuk ka bërë njoftimin në rrugë shkresore të palës kërkuese për zhvillimin e seancës gjyqësore të datës **.10.2013, sipas parashikimeve të neneve 128, 130, 141, 144, të Kodit të Procedurës Civile.*

20.3.5 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, në shpjegimet e tij ka deklaruar²⁸se: [...] *Fakti që, nga ana e nëpunësit të gjykatës është vendosur shënimi në fletëthirrjen e datës **.10.2013: “Mori dijeni me tel. për datën dhe orën e gjyqit”, në vlerësimin e gjykatës ka prezumuar dijeninë e rregullt të palës kërkuese për datën dhe orën e seancës gjyqësore, dhe në këto kushte është proceduar sipas rregullave të përgjithshme procedurale për pushimin e gjykimit të kërkesës. Duhet të sjell në vëmendje faktin se, një mënyrë e tillë e të proceduarit nga ana e gjykatës është diktuar edhe nga parimi i menjëhershmerisë së shqyrtimit të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit, e cila ka karakter të ngutshëm dhe duhet të përfundojë brenda një kohe sa më të shkurtër (në atë kohë ka pasur vakum ligjor në lidhje me mënyrën e procedimit dhe me afatin e shqyrtimit të kësaj kërkesë)[...].*

20.3.6 Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar²⁹se subjekti ka treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin, sipas parashikimit të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

20.4 Komisioneri Publik, bazuar edhe në Rekomandimin e ONM-së, të datës 25.4.2023, çmon se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me mangësitë procedurale të konstatuara.

²⁸ Referohuni propozimeve të subjektit të rivlerësimit, datë 23.2.2023.

²⁹ Referohuni vendimit të Komisionit, prg.104, faqe 54.

21. Ankesa e shtetasës ***.*** (***)

21.1 Shtetasja ***.***, në datën **.4.2014, ka paraqitur ankesë pranë Ministrisë së Drejtësisë, duke pretenduar se subjekti ka marrë vendimin nr. ***, datë **.2.2014, në kundërshtim me ligjin material dhe procedural.

21.2 **Rrethanat e faktit.** Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Vlorë është gjykuar çështja civile nr. *** akti, me palë: Paditës ***.*** (***); I paditur ***.***; Me objekt detyrimin e palës së paditur ta njohë trashëgimtare të ***.***, mbi pasurinë e tij që vjen nga trashëgimia e babait të tij, ***.***, ndodhur në ***, Himarë, Vlorë. Paditësja ka ngritur padinë, duke pretenduar se testamenti është i pavlefshëm, pasi e ndjera ka disponuar një pasuri që nuk e ka pasur në pronësi në momentin e hartimit të testamentit, si dhe për faktin se testamenti është hartuar në prani të një personi, i cili nuk mund të ishte i besuar, pasi gëzonte dhe cilësinë e trashëgimtarit ligjor të të ndjerës.

21.3 Me vendimin nr. ***, datë **.2.2014, subjekti i rivlerësimit ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin ***/**-2015-***, datë **.7.2015, ka vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë **.2.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, me një tjetër trup gjykues.

21.4 Gjykata e Apelit, ndër të tjera, ka arsyetuar se: [...] *gjykimi i çështjes në shkallë të parë është bërë në mungesë të palës së paditur dhe vendimi i zhvillimit të gjykimit në mungesë është marrë që në seancë përgatitore, gjë që bie ndesh me nenin 179 të Kodit të Procedurës Civile [...].*

21.5 Ministria e Drejtësisë, në përfundim të inspektimit, pasi ka administruar dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti, për rastet konkrete, ka konkluduar se në çështjen civile të përfunduar me vendimin nr. ***, datë **.2.2014, gjyqtari Laurent Fuçia nuk ka respektuar detyrimin ligjor të parashikuar nga neni 118 i K. të Pr. Civile, pasi nuk ka siguruar mbajtjen e procesverbalit sipas parashikimeve të kësaj dispozite. Ky konstatim i është dërguar me shkresën nr.*** prot., datë **.2.2016, Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me qëllim vlerësimin/konsiderimin e tij gjatë procedurës së vlerësimit të gjyqtarit Laurent Fuçia.

21.6 Sa më sipër, Komisioni, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin E, të aneksit të Kushtetutës, i ka kërkuar subjektit të paraqesë shpjegime, pasi duket se subjekti në gjykimin e çështjes civile nr. *** akti/nr.*** vendimi, datë **.2.2014, ka marrë vendimin për zhvillimin e gjykimit në mungesë të palës së paditur, në seancën e veprimeve përgatitore, duke vepruar jo sipas parashikimit të nenit 179, të Kodit të Pr. Civile, që parashikon se ky vendim merret në seancë gjyqësore.

21.7 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ndër të tjera, sa i përket marrjes së vendimit të ndërmjetëm për zhvillimin e gjykimit në mungesë të palës së paditur në seancën e veprimeve përgatitore, iu ka qëndruar të njëjtave shpjegime për të cilat i ka kaluar dhe më lart barra e provës.

21.8 Në përfundim, Komisioni ka arsyetuar,³⁰ edhe një herë, se subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin e zhvillimit të gjykimit në mungesë të palës së paditur në seancën e veprimeve

³⁰ Referohuni vendimit të Komisionit, prg. 132-133, faqe 59.

përgatitore, duke vepruar jo sipas parashikimit të neneve 179 të K. të Pr. Civile, që parashikon se ky vendim merret në rastet kur i padituri nuk paraqitet në seancë gjyqësore. Subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin, sipas parashikimit të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, por që e vetme nuk mund të përbëjë shkak për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

21.9 Komisioneri Publik, bazuar edhe në Rekomandimit të ONM-së, datë 25.4.2023, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës dhe mangësitë e konstatuara qëndrojnë.

22. Denoncimi nr. * prot., datë **.12.2021, dhe nr. *** prot., datë **.4.2022, të *** (***)**, i cili pretendon se trupa gjyqësore e Gjykatës së Apelit Vlorë, ***.***., ***.***. dhe Laurent Fuçia, ka marrë vendimin e datës **.12.2021, pa u bazuar në dispozitat procedurale.

22.1 *Rrethanat e faktit.* Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Vlorë ka gjykuar kërkesën civile të *** sh.a., me objekt rivendosjen në afat të ankimit ndaj vendimit nr. ***, datë **.12.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Vlorë.

22.2 Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Vlorë, me vendimin nr.***, datë **.12.1019, ka vendosur detyrimin e të paditurit *** sh.a., Njësia Vlorë, të dëmshpërblejë paditësin Nikolin Hasani, për shkak të dëmit të shkaktuar nga ndërprerja e energjisë elektrike, në shumën 291.723 euro.

